

## 8. TRUPA E MBROJTJES SË KOSOVËS

*“Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në tërësi zbatojnë mandatin e tyre, si është dhënë në Kornizën Kushtetuese, si “organizatë civile e ndërhyrjes së shpejtë e cila në raste fatkeqësive natyrore në Kosovë ndërmerr detyra për ndërhyrje të shpejtë për sigurinë publike në raste emergjente dhe të ndihmës humanitare”. TMK operon në mënyrë transparente, të përgjegjshme, të disiplinuar, profesionale dhe është përfaqësuese e tërë qytetarëve të Kosovës. TMK është në gjendje të zbaton masa disiplinore dhe është plotësisht e financuar në mënyrë transparente”*

### Gjendja e tanishme

TMK-ja ka bërë shumë të arritura në zhvillimin e saj si një organizatë civile emergjente. Megjithatë, tërësia e këtyre aftësimeve ka qenë e kufizuar për njësi më të specializuara në kuadër të strukturës së përgjithshme të saj. Përkundër kësaj, ata i kanë përbushur shumë mirë detyrat e tyre si në aftësimet jashtë vendit poashtu edhe në garat ndërkombëtare me theks të posaçëm në shuarjen e zjarreve, kërkim dhe shpëtim dhe ofrimin e ndihmës së parë mjekësore. TMK-ja, veç kësaj, nën mbikqyrjen ndërkombëtare, kryen operacione të spastrimit të vendeve me mjete të pashperthyera dhe mina. Gjatë dy viteve të kaluara, TMK-ja ka bashkëpunuar me organizata tjera në spastrimin e 20 rajoneve nga gjithsejt 120 sa janë identifikuar si zona të rrezikshëm në Kosovë. Vitin e kaluar, së bashku me KFOR-in dhe organizatat e ndryshme joqeveritare (OJQ), ka përcaktuar vendndodhjen dhe më pas shkatërrimin e mbi 4,000 mjeteve të pashpërthyera dhe minave. TMK-ja po ashtu ka angazhuar efektivin e saj në operacione të përgjegjës së shpejtë në raste të fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njerëzit. Vlen të përmendet angazhimi i TMK-së në reagimin e menjëhershëm me rastin e tërmetit në Gjilan në prill të vitit 2002 dhe atë të zjarrit në termo-elektranën e Kosovës në korrik 2002. Në disa raste tjera, edhe TMK-ja ka marrë pjesë në reagime të ndryshme emergjente në mbarë Kosovën. Gjatë dhunës së paradokohshme ndërmjet 17-20 marsit 2004, pjestarët e TMK-së kanë ofruar shërbime të ndihmës emergjente dhe në disa raste, me kërkesë të KFOR-it, kanë shërbyer si roja.

### Sfidat

Në bazë të Kornizës Kushtetuese, Trupa e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) është duke u zhvilluar si një organizatë civile emergjente e cila është në gjendje të kryejë detyra për reagim të shpejtë ndaj fatkeqësive në Kosovë. Për ta arritur këtë, TMK-ja duhet të jetë e përgatitur mirë dhe organizata duhet të zhvillojë strukturat e saja të brendshme të komandimit dhe kontrollit në mënyrë që puna e saj të jetë transparente, e përgjegjshme, me disiplinë dhe profesionalizëm. Përveç kësaj, TMK-ja duhet të angazhohet në mënyrë aktive për të bërë rekrutimin dhe mbajtjen e të gjitha bashkësive etnike në Kosovë si dhe të sigurojë

që pjesëtarët e TMK-së të cilët e shkelin Kodin Disiplinor të TMK-së të disiplinohen në mënyrë të drejtë dhe konsistente. Veç kësaj, është me rëndësi që financimi i TMK-së dhe proceset e brendshme të vendimmarrjes të jenë transparente.

### **Detyrat prioritare**

- Në përgjithësi, megjithë që TMK-ja ka bërë përparim ajo ende nuk është zhvilluar tërësisht. Disa fusha kërkojnë veprime prioritare:
- Duhet ndërmarrë masa për të siguruar që një numër më i madh i pjestarëve të TMK-së të vijojë aftësi të specializuara.
- TMK-së i nevojitet vlerësimi objektiv, në veçanti i strukturave komanduese dhe të kontrollit si dhe raportit mes Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së dhe Shtabeve të Zonave Mbrojtëse.
- TMK-ja duhet të përgatisë dhe zbatojë një strategji për rekrutimin, integrimin dhe mbajtjen e pjesëtarëve të të gjitha bashkësive presentë në Kosovë.
- Duhet të ndërmerren masa për sigurimin e fondeve për aftësi, pajisje dhe infrastrukturë.

Standardi	Detyra	Organi përgjegjës	Përkrahur nga	Afati
1. TMK kryen funksionet e dhëna me mandat në pajtim të plotë me ligjin.	1.1 Të gjithë pjesëtarët e TMK-së veprojnë në pajtim të plotë me Rregulloren e UNMIK-ut, 1999/8, dhe respektojnë faktin se TMK-ja është pushtet i rezervuar i PSSP-së, dhe KFOR-i siguron mbikqyrje të përditshme.	TMK	Z/KTMK KFOR	Në vijim e sipër
	1.2 TMK tregon se vepron sipas standardeve pergjithësisht të pranura evropiane dhe profesionale. Asnjë pjesëtar nuk avokon asnjë rol për TMK-në përveç atij që e përcakton Korniza Kushtetuese.	TMK	Z/KTMK KFOR	Tash e tutje
	1.3 Të gjithë bartësit e zyrave publike të IPVQ-së në mënyrë aktive miratojnë zvoglimin e numrit të pjesëtarëve të TMK-së në harmoni me rregulloren e UNMIK-ut 1999/8. Bartësit e tillë të zyrave publike më tej miratojnë pjesëmarrjen e të gjitha bashkësive të Kosovës në TMK dhe kërkojnë në mënyrë të pakufizuar që TMK-ja të veprojë në pajtim me mandatin e vet ligjor.	Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ)	Z/KTMK	Tash e tutje
	1.4 TMK-ja dhe pjesëtarët e vet nuk maërin pjesë në aktivitete politike, grupe apo lëvizje të ndaluara.	TMK	Z/KTMK KFOR	Në vijim e sipër
	1.5 Të gjithë pjesëtarët e TMK-së i kryejne detyrat e veta në përputhje të plotë me ligjin.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër
	1.6 Njesitë e caktuara specialiste brenda TMK-së aftësohen vazhdimisht në fusha të ndryshme si: kërkimshpëtim, zjarrfikje, deminim, teknika lirimi dhe mjeksia emergjente.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër

Standardi	Detyra	Organi përgjegjës	Përkrahur nga	Afati
	1.7 TMK-ja në partneritet me Zyren e Koordinatorit të TMK-së (ZK/TMK) dhe KFOR-in kërkon të marrë pjesë në trajnim që do t'i ndihmonte në arritjen e mandatit të vet ligjor.	TMK	Z/KTMK KFOR	Në vijim e sipër
	1.8 Per t'i zhvilluar planet operacionale dhe procedurat standarde operacionale TMK-ja përdor planin e fundit kosovar të vlerësimit të rrezikut dhe planin kosovar të reagimit të gatishmërisë emergjente.	TMK	Z/KTMK IPVQ	Deri në vjeshtë 2004
	1.9 TMK-ja zhvillon ushtrime të rregullta trajnimi në terren për të vlerësuar dhe shtuar aftësitë e veta për reagim të shpejtë.	TMK	Z/KTMK KFOR	Në vijim e sipër
	1.10 Kapaciteti deminues i TMK-së rritet vartësisht prej financimit shtesë. Deminerët e TMK-së i ushtrojnë pjesëtarët tjerë të TMK-së për teknikat deminuuese.	TMK	Z/KTMK	Tani e tutje
	1.11. Ekipet e deminimit të TMK-së janë të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare për veprim kundër minave.	Z/KTMK TMK	Z/KTMK	Çdo vit
	1.12. TMK-ja zhvillon kapacitetin për të trajnuar pjesëtarët e vet për përbushjen e kompetencave bazë të caktuara me mandat.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër
	1.13 TMK-ja bën inspektimin e pajisjeve të veta për të siguruar shprëndarjen proporcionale nëpër njësi dhe në pajtueshmëri me vlerësimin e rrezikut në Kosovë.	TMK	Z/KTMK KFOR	Deri në nëntor të 2004
	1.14 TMK-ja identifikon pajisjet dhe materialin tjetër të nevojshëm për kryerjen e detyrave të caktuara me mandat.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër

Standardi	Detyra	Organi përgjegjës	Përkrahur nga	Afati
2. Të gjitha bashkësitë pakicë përfaqësohen në TMK në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe pa qene të diskriminuar.	2.1 TMK-ja siguron se asnjë pjesëtar i tashëm apo i mundshëm i TMK-se të mos diskriminohet për shkak të racës, prejardhjes etnike, gjinisë apo orientimit seksual.	TMK	Z/KTMK	Tani e tutje
	2.2 Nga të gjithë pjesëtarët e TMK-së kërkohet të njihen dhe të marrin pjesë në politikën e jodiskriminimit.	TMK	Z/KTMK ZÇGJ (Zyra per çeshtje gjinore)	Në vijim e sipër
	2.3 Udhëheqja e TMK-së ndërmerr hapa për të siguruar pëlqimin me politikën e jodiskriminimit.	TMK	Z/KTMK ZÇGJ	Tani e tutje
	2.4 TMK-ja do të fillojë një fushatë gjithpërfshirëse dhe afatgjate për rekrutimin e pakicave etnike dhe arritjen e baraspeshës gjinore.	TMK	Z/KTMK IPVQ	Nga korriku 2004
3. Financimi është transparent dhe i nënshtrohet revizionimit të pavarur.	3.1 Buxheti i konsoliduar i Kosovës (BKK) për TMK jepet me kohë dhe është në gjendje t'u përgjegjet kërkesave të TMK-së.	MFE	Z/KTMK TMK	Januari i secilit vit
	3.2 Pjesa e TMK-së në BKK revidohet çdo vjet.	Revizori i pëgjithshëm	Z/KTMK; TMK	Si është dhënë nga RP
	3.3 Kërkohen donatorë ndërkombëtarë për t'i ndihmuar TMK-së ta kryej rolin e dhënë me mandat, përmes blerjes së pajisjeve esenciale per misionin e vet.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër
	3.4 TMK-ja zbulon plotësisht burimet dhe shumat e të gjitha donacioneve të pranuar duke përfshirë po jo duke u kufizuar me "Miqte e TMK-së". TMK-ja në mënyrë të saktë tregon se si janë shfrytëzuar ato fonde dhe sipas kërkesës ia nënshton fondet e veta sistemit të revizionimit dhe inspektimit.	TMK	Z/KTMK	Tani e tutje
4. Numri i instalimeve te TMK-së është zvogëluar së paku për një të	4.1 Elementi aktiv i TMK-së është 3.052	TMK	Z/KTMK	I arritur

Standardi	Detyra	Organi përgjegjës	Përkrahur nga	Afati
tretën. Madhësia e kontigjentit të pjesës aktive është zvogëluar në 3.052-pjesëtarë-kurse-pjesa-rezerve numëron 2.000 pjesëtarë.	4.2 Elementi rezervë i TMK-së është 2.000	TMK	Z/KTMK	I arritur
	4.3 Stabilimentet e TMK-së të zvogëlohen se paku për një të tretën në përpjestim të drejtë me pjesën aktive dhe rezervë të TMK-së dhe në harmoni me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/8	TMK	Z/KTMK	Deri në fund të 2004-ës
5. Të gjitha shkeljet dënohen sipas një kodi disiplinor rigoroz dhe sistemit të vlerësimit të punës.	5.1 TMK-ja mbështet një sistem disiplinor të vërtetuar nga JSEC-i që në mënyrë strikte i përmbahet Kodit disiplinor aktual të TMK-së	TMK	Z/KTMK KFOR JSEC	Në vijim e sipër
	5.2 Është rishikuar Kodi disiplinor i TMK-së për të siguruar se i njëjti është efikas, i drejtë dhe përkon me normat ndërkombëtare në procesin e duhur. Procedura e korrigjuar e rishqyrtimit është miratuar dhe zbatuar.	Z/KTMK KFOR JSEC TMK	ZKL Z/KTMK KFOR	Deri në maj 2004
	5.3 Jane rishikuar dispozita të rëndësishme të Kodit disiplinor të TMK-së.	Z/KTMK KFOR TMK	Z/KTMK KFOR JSEC	Deri në korrik 2004
	5.4 Janë zbatuar masa për të siguruar që ndërmarrja e masave disiplinore kundër pjesëtarëve të TMK-së nuk do të bëhet në mënyrë diskriminuuese.	Z/KTMK KFOR JSEC TMK	Z/KTMK KFOR	Në vijim e sipër
	5.5 Është miratuar kodi disiplinor i korrigjuar dhe i plotësuar i TMK-së.	Z/KTMK KFOR JSEC TMK	ZKL Z/KTMK KFOR	Gusht 2004
	5.6 TMK-ja miraton dhe zbaton një politikë të rishikuar të përmbushjes së obligimeve.	TMK	Z/KTMK KFOR	Deri në vjeshtë 2004
6. TMK-ja është angazhuar në një fushatë gjithëpërfshirëse të	6.1 TMK-ja sajton një plan fushate në formë të shkruar për rekrutimin e pjesëtarëve të gjitha bashkësive etnike.	TMK	Z/KTMK	Deri në qershor 2004

Standardi	Detyra	Organi përgjegjës	Përkrahur nga	Afati
rekrutimit nëpër bashkësi të pakicave etnike.	6.2 TMK-ja siguron vende për pjestarët e të gjitha bashkësive etnike në komponentën aktive dhe rezervë të TMK-së.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër
	6.3 TMK-ja zhvillon një fuhsatë të re të përgjithshme rekrutimi në Kosove për rekrutimin e pjestarëve të gjitha bashkësive etnike.	TMK	Z/KTMK	Nga korriku 2004
	6.4 Në pajtueshmëri me Rregulloren 1999/8, TMK-ja ndërmerr hapa aktivë për ta shtuar anëtaresinë e vet me minoritarë në nivelin 10% në rradhët e veta të përgjithshme. TMK-ja siguron se pjesëmarrja e minoritarëve në aktivitetet e TMK-se është kuptimplote dhe se ata nuk janë të diskriminuar.	TMK	Z/KTMK	Në vijim e sipër
7. TMK-ja ka përkushtuar një pjesë proporcionale të rindërtimit në bashkësitë e pakicave etnike.	7.1 Projekt planet e reja të rindërtimit në rajonet e pakicave të zhvillohen në lidhshmëri me ZUKÇB/UNMIK dhe IPVQ. Fondet të kërkohen nga donatorët dhe/ose BKK-ja. Aktivitetet e rindërtimit nuk do të duhej të përfshijnë vetëm riparimin e infrastrukturës por edhe ndihmën në evakuim, shprëndarjen e ushqimit, shprëndarjen e drujve për nxemje dhe aktivitete tjera të ngjashme.	TMK	Z/KTMK Zyra e UNMIK-ut për të Kthyerit dhe për Çështje të Bashkësive (ZUKÇB) Donatorë nga bashkësia ndërkombëtare IPVQ	Deri në qershor 2004
	7.2 Projektet e cekura në pikën 7.1 janë zbatuar dhe projekte të ngjashme janë zhvilluar në vazhdimësi.	TMK	Z/KTMK Donatorë nga bashkësia ndërkombëtare.	Nga qershori 2004
8. Është miratuar dhe zbatohet Ligji për kushtet e shërbimit për pjesëtarët aktivë dhe rezervë.	8.1 Është shpallur Ligji për kushtet e shërbimit.	Z/KTMK TMK	ZKL	Deri në qershor 2004

Standardi	Detyra	Organi përgjegjës	Përkrahur nga	Afati
	8.2 Ligji për kushtet e shërbimit përfshin dispozita që sigurojnë baraspeshen gjinore dhe jodiskriminim në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Z/KTMK TMK	ZKL ZÇGJ (Zyra e UNMIK-ut për çështje gjinore)	Deri në qershor 2004
	8.3 Dispozitat që do ta implementojnë ligjin do të shpallen dhe mekanizmat e korrigjimit do të krijohen sipas nevojës.	Z/KTMK TMK	ZKL	Nga qershori 2004

### Fjalorth

BKK	Buxheti i konsoliduar i Kosovës
BN	Bashkësia ndërkombëtare
IOM	Organizata ndërkombëtare për migrim
IPVQ	Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes
KFOR	Forca e NATO-s në Kosovë
KPES	Komiteti i përbashkët ekzekutiv i sigurisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RP	Revizori i përgjithshëm
TMK	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
ZÇGJ	Zyra për çështje gjinore
ZKJ	Zyra e Këshilltarit Juridik të UNMIK-ut
Z/KTMK	Zyra e Kordinuesit të TMK-së, Zyra e UNMIK-ut e Zëvendësit kryesor të PSSP-së
ZUKÇB	Zyra e UNMIK-ut për të Kthyerit dhe për Çështje të Bashkësive